



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ KANCELARIJA ZA JAVNO KOMUNICIRANJE/
/OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION/

THIRRJE PËR APLIKIM
PËR FERMERËT DHE EKONOMITË BUJQËSORE TË KOMUNAVE:
PRISHTINË, PRIZREN DHE MITROVICË

PËR PËRFITIM NË KUADËR TË IMPLEMENTIMIT TË PROGRAMIT SPECIAL "ZONAT RURALE MË PAK TË ZHVILLUARA" PRODUKTET JODRUSORE TË MALIT: FRUTAT, KËRPUDHAT DHE BIMËT AROMATIKE DHE MJEKËSORE.

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është dhënia e ndihmës financiare/granteve për investime në ferma në kuadër të programit special "Zonat rurale më pak të zhvilluara", **produktet jodrusore të malit: frutat, kërpudhat dhe bimët aromatike dhe mjekësore**

II. Përfituesit e mundshëm

Përfituesit për këtë masë mund të jenë personat fizik ose juridik, të cilët:

- Janë të regjistruar në Regjistrin e Bizneseve në Kosovë (personat juridik). Personat fizik duhet që brenda 10 ditësh nga data e njoftimit që janë përzgjedhur të regjistrojnë ndërmarrjen e tyre;
- Janë të regjistruar në Regjistrin e Fermerëve;
- Të marrin lejen përkatëse për të zhvilluar këtë aktivitet nga Departamenti i Pylltarisë në MBPZHR;
- Të dëshmojnë se kanë paguar të gjitha obligimet (tatimet) ndaj shtetit dhe komunës që i përkasin;
- Të nënshkruajnë një deklaratë me të cilën obligohen se do t'ju përmbahen kriterëve të përzgjedhjes edhe tri vjet pas marrjes së pagesës;

- Investimet, ku përfshihen edhe makinat duhet t'i mbajnë së paku 3 vjet pas pranimit të grantit;
- Të dorëzohet një plan biznesi i punuar sipas udhëzimeve të MBPZHR-së.

Përfituesit e kategorisë 1 janë mbledhësit, që produktet i marrin drejtpërdrejt nga vjelësit dhe i dorëzojnë në qendrat grumbulluese.

Ata duhet të dëshmojnë se:

- Në dy vitet e fundit kanë mbledhur dhe dorëzuar çdo vit të paktën 15 tonë të këtyre produkteve.
- Kanë së paku 5 punëtorë (ekuivalente me punëtorë me orar të plotë).
- Kanë pronësinë mbi tokën dhe objektin ku janë paraparë të bëhen investimet ose toka është kontraktuar për të paktën tre vjet.

Përfituesit e kategorisë 2 - grumbulluesit qendror, që kanë kontrata me përfituesit e kategorisë 1, që janë duke përpunuar prodhimin dhe duke e eksportuar atë, duhet të dëshmojnë se:

- Për projektet me vlerë nën 20,000 Euro duhet ta dorëzojnë projekt-propozimin, i cili përmban: përshkrimin e gjendjes ekzistuese në fermë, përshkrimin e investimeve të nevojshme dhe koston e investimeve;
- Të dorëzohet një plan biznesi i punuar sipas udhëzimeve të MBPZHR-së. (për projektet me vlerë mbi 20,000 Euro);
- Kanë pranuar dhe përpunuar çdo vit të paktën 100 tonë të frutave të malit, kërpudhave dhe bimëve aromatike dhe mjekësore në dy vitet e fundit;
- Kanë së paku 5 punëtorë (ekuivalent me punëtorë me orar të plotë);
- Kanë eksportuar të paktën 90% të prodhimit të tyre;
- Kanë pronësinë mbi tokën dhe objektin ku janë paraparë të bëhen investimet ose toka është kontraktuar për të paktën tre vjet;
- Të dëshmojnë se kanë paguar të gjitha obligimet (tatimet) ndaj shtetit dhe komunës që i përkasin;
- Të nënshkruajnë një deklaratë me të cilën obligohen se do t'ju përmbahen kritereve të përzgjedhjes edhe tri vjet pas marrjes së pagesës.

III. Makinaria/pajisjet e pranueshme për:

A. Përfituesit e kategorisë 1

- Tharëset
- Frigoriferët
- Makina për pastrim
- Makina për prerje (grirje)

- Gjeneratorët elektrikë, me një kapacitet konform shpenzimit të energjisë elektrike.

B. Përfituesit e kategorisë 2

Makina për pastrim, klasifikim, tharje, ftohje, ngrirje, qërim, paketim, etiketim.
Makineria/pajisjet mund të përdoren gjithashtu edhe për prodhim të kultivuar.

Prodhimi i paraparë duhet të mbulohet nga:

- Kontrata/para-kontrata me blerësit për vitin/sezonin e ardhshëm për së paku 50% të prodhimit të parashikuar nga i cili 25% me kontrata.
- Kufiri më i lartë i investimeve të pranueshme për përfituesit e Kategorisë 1 është 20,000 € Euro/projekt dhe kufiri më i lartë i investimeve të pranueshme për përfituesit e Kategorisë 2 është 100,000 € Euro/projekt.

Intensiteti i ndihmës: 75 % nga shpenzimet totale të pranueshme

Për përfituesit e të dy kategorive, 1 dhe 2 vlen:

Kthimi i investimit duhet të realizohet brenda tri viteve.

Sqarim: prodhimi i shtuar si rezultat i investimit (i shprehur në vlerë monetare) në tri vitet pas investimit, duhet të jetë më i lartë se vlera e investimit. Kjo duhet të jetë e specifikuar në planin e biznesit.

Në rast të një projekti për blerjen e më shumë pajisjeve/makinave, pagesat mund të pranohen deri në 2 këste, me kërkesë të veçantë të përfituesit, duke konsideruar se pagesa e parë është më e lartë se 50% e pagesave totale. Nëse përfituesi nuk e kërkon në kohën e duhur pagesën e dytë, do të duhet të kthejë të gjithë mbështetjen e marrë.

IV. Shpenzimet (kostot) e papranueshme:

- shpenzimet e kamatës;
- investimet e financuara nga ndonjë projekt i mëhershëm;
- blerja e tokës apo ndërtesave;
- zëvendësimet/renovimet e thjeshta të ndërtesave apo makinerisë;
- humbjet nga këmbimi i valutave;
- tatimet, përfshirë TVSH-në;
- blerjet e pajisjeve të përdorura;
- gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet gjyqësore;
- kontributet në material / mallra;
- shpenzimet e amortizimit (zhvlerësimit);
- ndalesat bankare, shpenzimet e garantuesit dhe ndalesat tjera të ngjashme, si dhe

- shpenzimet për doganim apo import, apo pagesa tjera.

V. Shtrirja gjeografike

Komunat: Prishtinë, Prizren dhe Mitrovicë

VI. Koha dhe mënyra e marrjes së formularëve për aplikim

Thirrja për aplikim do të jete e hapur 45 ditë nga data e publikimit, procedimi i aplikacioneve do të behet sipas parimit të kritereve të përzgjedhjes, të përcaktuara paraprakisht nga MBPZHR-ja.

Data e fillimit të dorëzimit të formularit për aplikim është dita pasi të jetë publikuar thirrja për aplikim.

Përfituesi duhet të shkojë në zyrën komunale për bujqësi dhe të marrë dokumentet e nevojshme për të aplikuar.

Me përkrahjen e zyrtarit këshillues komunal ose vetë përfituesi bën plotësimin e formularit për aplikim dhe siguron dokumentet e nevojshme.

Formulari për aplikim dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të dorëzohen në zyrën komunale për bujqësi çdo ditë pune nga ora 9:00-15:30.

VII. Kontaktet dhe pikat (vendet) informuese lidhur me aplikimin

Kontaktet dhe pikat informuese lidhur me aplikimin mund t'i merrni në komunat përkatëse, gjegjësisht në zyrën për bujqësi, nga e hëna deri të premten: prej orës 09:00-15:30;

MBPZHR			
Nga e hëna deri të premten: nga 10:00 ^h -12:00 ^h			
1	Departamenti i Pagesave		038 211 967
Drejtoritë Komunale të Bujqësisë			
Nga e hëna deri të premten: nga 09:00 ^h -15:30 ^h			
Nr.	Komuna	Personi kontaktues;	Telefoni
1	Prishtinë	Ylli Demolli	044/277-610
2	Mitrovicë	Bedri Bajrami	044/245-821
3	Prizren	Jakup Kastrati	044/217-235